

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegj i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare, Avdi Dinaj dhe Valdete Daka, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarve F. M., R. M. dhe B.B., për shkak të veprave penale vrasje e rëndë, nga neni 179 par. 1 pika 11 të KPK, vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 par. 1 pika 11 lidhur me nenin 28 dhe 29 të KPK-së, mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 par. 1 të KPK dhe pjesëmarrja në rrahje nga neni 190 par. 2 të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit F. M., N. N., av. nga Gjilani, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti i krimeve të rënda në Gjilan, PKR.nr.156/2014 datë 18 gusht 2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit –Departamenti për krime të rënda Prishtinë, PAKR.nr.466/2015 datë 19.11.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur më 29 shkurt 2016, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit F. M., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti i krimeve të rënda në Gjilan, PKR.nr.156/2014 datë 18 gusht 2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit –Departamenti për krime të rënda Prishtinë, PAKR.nr.466/2015 datë 19.11.2015.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-Departamenti i krimeve të rënda në Gjilan, PKR.nr.156/2014 datë 18 gusht 2015 të dënuarit F. M., R. M. dhe B. B., janë shpallur fajtorë; F. M., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë, nga neni 179 par. 1 pika 11 të KPK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 par. 1 të KPK, R.M., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 par. 1 pika 11 lidhur me nenin 28 e 29 të KPK dhe mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 par. 1 të KPK, B. B., për shkak të veprës penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 190 par. 2 të KPK dhe pasi që më parë të dënuarve F. dhe R. M., u janë caktuar dënimet janë gjykuar, i dënuari F. M., me dënim unik burgu në kohëzgjatje prej 25 (njëzetepesë) vitesh, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej 25.11.2013 e tutje, R. M., me

dënim unik burgu në kohëzgjatje prej 13 (trembëdhjetë) vitesh e 6 (gjashtë) muajsh, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej 25.11.2013 e tutje kurse B, B., me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh e 6 (gjashtë) muajsh në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej 15.11.2013 gjer më 15.7.2015. Të dënuarit janë detyruar që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale në mënyrë solidare në shumë prej 140,88 € dhe secili prej tyre shumë prej nga 200 € në emër të paushallit gjyqësor. Bëhet konfiskimi i revoles “...” e kal. ... mm, me nr. serik ..., një arme “...” ... e kal. ... mm, me nr. serik ..., një karikator me 8 fishekë, dy sëpata, tri thika, një fotrollë e thikës, disa rroba, një shufër metalike e ndarë në dy pjesë dhe një drapër. Të dëmtuarit F., dhe A. L., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzon në kontest civil.

Ky aktgjykim është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit – Departamentit për krime të rënda Prishtinë PAKR.nr.466/2015 datë 19.11.2015.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit F. M., për shkak të shkeljes së Ligjit penale propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen, çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Prokurori i Shtetit të Kosovës me parashtrësën KMLP.II.nr.25/2016 datë 9.2.2016 ka dhënë përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë me propozim që kërkesa të refuzohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit i shqyrtoi shkresat e çështjes konform dispozitës së nenit 435 par. 1 dhe 436 par 1 të KPPK-së, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se në veprimet e të dënuarit E. M., qëndrojnë elementet qenësore të veprës penale të kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore nga neni 180 të KPK apo të vrasjes së rëndë në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme nga par. 3 dhe 4 të nenit 12 të KPK, meqë i dënuari F. M., është lënduar nga të dëmtuarit para se të përdorë armën e që këto veprime qartë tregojnë se tek i dënuari nuk ka ekzistuar dashja për kryerjen e veprës penale. Konsideron se edhe dënimi i shqiptuar është i lartë meqë i dënuari u ka kërkuar falje të dëmtuarve, ka shprehur pendim për kryerjen e veprës penale.

Gjykata Supreme vlerëson se pretendimet e cekura në kërkesë për mbrojtjen e ligshmërisë, shkelje këto të theksuara në ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, nuk janë të bazuara nga këto arsye:

Në mbështetje të provave të administruara në këtë çështje penale, gjykata e shkallës së parë me pa mëdyshje ka vërtetuar rrethanën se F. Maliqi të dënuarin R., e ka djalë ndërsa i dënuari B. B., është shok i të dënuarit R. M., ndërsa familjen e dëmtuarve L., të ndjerët (F. dhe A. si dhe të dëmtuarit F. dhe A.) i kanë pasur fqinj. Nuk janë kontestuese rrethanat se gjer në ditën kritike raportet mes këtyre dy familjeve kanë qenë të mira. Nuk janë kontestuese se në afërsi të shtëpive të dënuarit kanë pasur të vendosur një kioskë, kurse familja e të dëmtuarve skaj rrugës afër kioskut kishte të vendosura paleta. Meqë këto paleta dikush më parë i kishte rrëzuar, i dëmtuari F. L., afër taksistëve tek qebaptorja e R. M., kishte pyetur nëse din, kush i kishte rrëzuar paletat e vendosura skaj rrugës. I dëmtuari F., i kishte rregulluar paletat dhe ishte kthyer në shtëpi. Sërish pas gjysmë ore dikush i kishte rrëzuar këto paleta. Me këtë rast i dëmtuari F. me babanë e tij – të ndjerin Fitim si dhe të ndjerin A. (vëllai i të ndjerit F.) kanë dalë dhe i kanë rregulluar këto paleta.

Edhe nga vet mbrojtja e të dënuarve vërtetohet se i dënuari R. M., e fton babanë e tij F.M., se a mos kishte pasur konflikt me familjen L. I dënuari F., i cili kishte qenë mysafir tek motra e tij, menjëherë kthehet në shtëpi, me ç’rast bashkëshortja e të dënuarit F., së bashku me nipin, hynë në shtëpi, me ç’rast i dënuari F., bashkëshortes (T.) i thotë që ta ftoj të birin e tyre Ruzhdiun i cili ishte në qytet ndërsa vet del nga shtëpia i armatosur, shkon në familjen e dëmtuar. Po ashtu edhe i dënuari B. B., vërteton rrethanën se ishte në automjetin e të dënuarit Ruzhdi dhe se gjatë rrugës në hyrje të Gjilanit Ruzhdiu i tregon se e ka sulmuar dhe sharë babai i Fidanit lidhur me disa paleta që ishin rrëzuar dhe kthehen në shtëpinë e të dëmtuarit Ruzhdi, me ç’rast i dënuari Ruzhdi e pyet nënën (T.) për babain F., dhe del nga shtëpia, ku sipas të dëmtuarve Ruzhdiu vjen me sëpatë dhe thikë dhe në ato çaste, gjersa i dënuari F., kishte hyrë në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarve i thotë të ndjerit Fitim “qysh t’ia bëjmë me ato paleta që i keni vendosur” ndërsa i ndjeri F., i përgjigjet se “Paletat janë vendosur në pronën e tyre”.

Sipas të dëmtuarit F., i dënuari F., u thotë të dëmtuarve “nëse doni po ju largoj kioskën” për çfarë merr përgjigjen se kioska i të dënuarve nuk është në pronën e tyre dhe duke dalë jashtë dyerve të të dëmtuarve në ato çaste vie i dënuari R., me sëpatë në dorë i cili e sulmon të ndjerin F., me ç’rast i njëjti arrin t’ia kapë sëpatën , ndërsa i dënuari F., tërhiqet nga mbrapa, nxjerr

revolen duke i ndërmarrë veprimet inkrimiuese siç më hollësisht është përshkruar në aktgjykimet e kundërshtuara.

Në fillim duhet theksuar se nga rrjedha e ngjarjes kritike, qartë rezulton se konfliktin e fillojnë të dënuarit për faktin se të dëmtuarit kishin vendosur paletat në pronën e tyre por përskaj rruge, andaj nga kjo është absurde që iniciuesit e konfliktit të thirren në veper penale të privilegjuar ngase ngjarja nuk është zhvilluar në rrethanat e privileguara.

Për ekzistimin e vrasjes në rrethanat e privileguara siç pabazë pretendon mbrojtësi në kërkesë duhet përmbushur kushtet që vrasja të jetë kryer në gjendje të tronditjes së fortë, se kryesi pa fajin e tij të ketë rënë në këtë gjendje për shkak të sulmit ose fyerjes së rëndë të viktimës. Në gjendje të afektit, aftësia për të kuptuar pakësohet sepse afekti mbizotëron në ndërgjegje dhe pakësohet aftësia e kontrollit të veprimit.

Po ashtu, ndërmjet sulmit përkatësisht fyerjes së rëndë dhe tronditjes së fortë psikike patjetër duhet të ekzistojnë lidhja kauzale. Në rastin konkret asnjëra nga këto kushte ligjore nuk është përmbushur për faktin se konfliktin e kanë iniciuar të dënuarit dhe pikërisht për t'u konfliktuar kishin shkuar të armatosur në oborrin e të dëmtuarve se të ndjerët dhe të dëmtuarit me asnjë veprim nuk i kishin kontribuar shkaktimin të konfliktit andaj pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë se veprat penale janë kryer në rrethanat e privileguara, qartazi janë të pabaza.

Vlen të theksohet se cilësimi juridik i veprave penale është rezultat i vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, për çka pretendimet se është shkelur Ligji penal në dëm të të dënuarve, është qartazi i pabazë.

Nga arsyet e theksuara më lartë e konform dispozitës së nenit 437 të KPPK-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit është refuzuar si e pabazuar dhe është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË**

PML.nr.36/2016 DATË 29 shkurt 2016

Procesmbajtëse,  
Qefsere Berisha

Kryetare e kolegjit,  
Emine Mustafa

